

**DEKLARATA E PARIMEVE PËR VËZHMIN
NDËRKOMBËTAR TË ZGJEDHJEVE**

dhe

**KODI I SJELLJES PËR VËZHUESIT
NDËRKOMBËTARË TË ZGJEDHJEVE**

**DEKLARATA E PARIMEVE
PËR VËZHGIMIN
NDËRKOMBËTAR TË
ZGJEDHJEVE**

dhe

**KODI I SJELLJES PËR
VËZHGUESIT PËR
NDËRKOMBËTARË TE
ZGJEDHJEVE**

Organizatat nënshkruese, 4 Tetor, 2005

Unioni Afrikan
Rrjeta Aziatike për Zgjedhje të Lira
(ANFREL)
Qendra Carter
Qendra për Promovim dhe Asistencë të
Zgjedhjeve (CAPEL)
Sekretariati i Commonëalth-it
Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian për
Demokraci nëpërmes ligjit (Komisioni i
Venedikut)
Këshilli i Evropës – Asambleja Parlamentare
Instituti Elektoral i Afrikës Jugore (EISA)
Komisioni Evropian
Rrjeta Evropiane e Organizatave për
Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO)
Shërbimet Ndërkombëtare për Reforme
Zgjedhore (ERIS)
IFES
IDEA Internacionale
Unioni Inter-Parlamentar
Instituti Republikan Ndërkombëtar (IRI)
Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)
Organizata e Shteteve Amerikane (OAS)
Organizata për Siguri dhe Kooperim në
Evropë, Zyra Institucioneve Demokratike dhe
të Drejtave Humane (OSCE/ODIHR)
Ishujt Pacifik, Australi & Zelanda e Re
Asociacioni i Administratorëve Elektoral
(PIANZEA)
Forum i Ishujve Pacifik
Sekretariati i Kombeve të Bashkuara
Asociacioni i Kombeve të Bashkuara i ish-
anëtarëve të Kongresit (USAFMC)

*Kjo Deklaratë dhe Kodi i bashkangjitur i
Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtar të
Zgjedhjeve mbetet i hapur për miratim nga
organizatat tjera ndërqeveritare dhe
ndërkombëtare joqeveritare. Miratimet duhet
të regjistrohen në Divizionin për Asistencë
Elektorale të Kombeve të Bashkuara*

DEKLARATA E PARIMEVE PËR VËZHGIMIN NDËRKOMBËTAR TË ZGJEDHJEVE

Tetor 27, 2005

Zgjedhjet e drejta demokratike janë shprehje e sovranitetit, që i përket njerëzve të një vendi, shprehja e lirë e të cilëve ofron një bazë për autoritet dhe legjitimitet të qeverisë. Të drejtat e qytetarëve për të votuar dhe për t'u zgjedhur në zgjedhje periodike dhe të mirëfillta demokratike, janë të drejta njerëzore ndërkombëtarisht të njohura. Zgjedhjet e drejta demokratike shërbejnë për të zgjidhur në mënyrë paqësore garën për fuqi politike brenda një vendi dhe si të tilla janë qenësore për mbajtjen e paqes dhe stabilitetit. Aty ku qeveritë janë legjitimuar nga zgjedhjet e drejta e demokratike, hapësira për sfidave jo-demokratike në kuadër të qeverisjes është e zvogëluar.

Zgjedhjet e drejta demokratike janë një kusht i nevojshëm për qeverisje demokratike, për shkak se janë një mjet, nëpërmes të cilit njerëzit e një vendi e shprehin në mënyrë të hapur vullnetin e tyre, në baza të vendosura sipas ligjit, për të legjitimuar ata të cilët do të udhëheqin në emër të tyre dhe në interes të tyre. Arritja e zgjedhjeve të drejta demokratike është pjesë e ndërtimit të proceseve dhe institucioneve më të gjëra të qeverisjes demokratike. Prandaj, përderisa të gjitha proceset zgjedhore duhet të reflektojnë principet universale për zgjedhje të drejta demokratike, ato nuk mund të ndahen nga konteksti politik, kulturor dhe historik në të cilin ndodhen.

Zgjedhjet e drejta demokratike nuk mund të arrihen pa ushtrimin e vazhdueshëm të një vargu të gjërë të të drejtave tjera humane dhe fundamentale, duke përfshirë diskriminim e bazuar në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë, religjion, politikë apo mendime tjera, origjinë nacionale apo sociale, pasuri, lindje apo status tjetër, përfshirë këtu edhe paaftësitë, si dhe pa kufizime arbitrare dhe jo të arsyeshme. Zgjedhjet, sikur edhe të drejtat tjera njerëzore dhe demokracia në përgjithësi, nuk mund të arrihen pa sigurimin e sundimit të ligjit. Këto norma janë të pranuar nga të drejtat njerëzore dhe instrumentet tjera ndërkombëtare si dhe nga dokumentet e shumta të organizatave ndërqeveritare. Prandaj, arritja e zgjedhjeve të drejta demokratike është bërë një çështje që brengosë organizatat ndërkombëtare, sikur që është edhe brengë e institucioneve nacionale, konkurrentëve politikë, qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve shpreh interesimin e komunitetit ndërkombëtar në arritjen e zgjedhjeve demokratike, si pjesë e zhvillimit demokratik, duke përfshirë respektimin e të drejtave njerëzore dhe sundimin e ligjit. Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve, i cili fokusohet në të drejtat civile dhe politike, është pjesë e monitorimit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe duhet të mbahet në bazë të standardeve më të larta të objektivitetit sa i përket kompetitorëve kombëtar politik, dhe duhet të jetë i çliruar nga çdo faktor bilateral apo multilateral që do të mund të bie ndesh me objektivitetin. Ai vlerëson proceset zgjedhore në pajtim me parimet ndërkombëtare për zgjedhje të drejta, demokratike dhe ligjin e vendit, duke ditur që janë njerëzit e vendit ata që në mënyrë ultimative e përcaktojnë kredibilitetin dhe legjitimitetin e një procesi zgjedhor.

Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve ka potencial për rritjen e integritetit të proceseve zgjedhore, duke përcaktuar dhe paraqitur irregullaritetet dhe mashtrimet, dhe duke ofruar rekomandime për përmirësimin e proceseve zgjedhore. Ai mund të promovon besueshmërinë publike, si garantues, mund të promovon pjesëmarrjen elektorale dhe të zvogëloj mundësitë për konflikte të mundshme që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Gjithashtu, mund të shërben për rritjen e mirëkuptimit ndërkombëtar duke ndarë së bashku përvojat dhe informacionet lidhur me zhvillimet demokratike.

Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve është pranuar gjerësisht në botë dhe luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e vlerësimeve të sakta dhe objektive lidhur me natyrën e proceseve zgjedhore. Vëzhgimi ndërkombëtar i saktë dhe objektiv i zgjedhjeve kërkon metodologji të besueshme dhe bashkëpunim me autoritetet nacionale, konkurruesit politik nacional (partitë politike, kandidatët dhe përkrahësit e pozicioneve në referendum), organizatat vendore monitoruese të zgjedhjeve dhe organizatat tjera ndërkombëtare, vëzhguese kredibile të zgjedhjeve.

Prandaj, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare, nënshkruese të kësaj Deklarate dhe Kodit të Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve, janë pajtuar për të deklaruar se:

1. Zgjedhjet e drejta demokratike janë shprehje e sovranitetit, që i përket njerëzve të një vendi, vullneti i lirë i të cilëve ofron një bazë për autoritet dhe legjitimitet të qeverisë. Të drejtat e qytetarëve për të votuar dhe për t'u zgjedhur, në zgjedhje periodike, të drejta demokratike, janë të drejta njerëzore ndërkombëtarisht të njohura. Zgjedhjet e drejta demokratike janë qenësore për mbajtjen e paqes dhe stabilitetit dhe ofrojnë mandat për qeverisje demokratike.
2. Në pajtim me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike dhe instrumentet tjera ndërkombëtare, çdo njeri ka të drejtë dhe atij duhet t'iu mundësohet pjesëmarrja në punët qeveritare dhe publike të vendit të tij apo saj, pa asnjë diskriminim që është i ndaluar me parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe pa asnjë kufizim jo të arsyeshëm. Kjo e drejtë mund të ushtrohet drejtpërdrejtë, duke marrë pjesë në referendum, duke u kandiduar për post, apo mund të ushtrohet nëpërmes përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të lirë.
3. Vullneti i njerëzve të vendit paraqet bazë për autoritetin e qeverisë, dhe ky vullnet duhet të përcaktohet nëpërmes zgjedhjeve të drejta, periodike, të cilat garantojnë të drejtën dhe mundësinë për të votuar lirshëm dhe për t'u zgjedhur në mënyrë të drejtë nëpërmes të drejtës universale dhe të njëjtë për votim me vota të fshehta apo procedurave ekuivalente të lira votuese, rezultatet e të cilave numërohen saktë, shpallen dhe respektohen. Prandaj, në arritjen e zgjedhjeve të drejta demokratike përfshihen një numër i konsiderueshëm i të drejtave dhe lirive, proceseve, ligjeve dhe institucioneve.

4. Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve është: mbledhje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe e saktë e informacioneve lidhur me ligjet, proceset dhe institucionet që kanë të bëjnë me mbajtjen e zgjedhjeve dhe faktorët tjerë që kanë të bëjnë me ambientin e përgjithshëm elektoral; analizë objektive dhe profesionale e informacioneve të tilla; dhe nxjerrje e konkludimeve lidhur me karakterin e proceseve elektorale bazuar në standardet më të larta për saktësi të informacioneve dhe objektivitet të analizave. Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve duhet, atëherë kur është e mundur, të ofron rekomandime për përmirësimin e integritetit dhe efektivitetit të proceseve elektorale dhe të ngjashme, duke mos ndërhyrë dhe duke mos penguar proceset e tilla. Misionet e vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve janë: përpjekje të organizuara të organizatave dhe asociacioneve ndërqeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare për të kryer vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve.
5. Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve vlerëson periudhën para-zgjedhore, ditën e zgjedhjeve dhe periudhën pas-zgjedhore nëpërmes të vëzhgimit gjithëpërfshirës, afat-gjatë, duke përdorur një varietet të teknikave. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, misionet e specializuara vëzhguese mund të ekzaminojnë çështjet para-zgjedhore dhe pas-zgjedhore dhe proceset specifike (si p.sh., caktimi i kufijve të distrikteve/zonave elektorale, regjistrimi i votuesve, përdorimi i teknologjive elektronike dhe funksionimi i mekanizmave që kanë të bëjnë me ankesat zgjedhore). Gjithashtu mund të përdoren edhe misionet vëzhguese të specializuara, dhe ato duhet të bëjnë deklarime të qarta publike që aktivitetet e tyre dhe konkluzionet janë të kufizuara, dhe që nuk marrin konkludime rreth proceseve të përgjithshme zgjedhore, duke u bazuar në aktivitete të tilla të kufizuara. Të gjitha misionet vëzhguese duhet të bëjnë përpjekje të përbashkëta që të vendosin ditën e zgjedhjeve në kontekstin e tyre, dhe mos të tej-theksojnë rëndësinë e vëzhgimit në ditën e zgjedhjeve. Vëzhgimi ndërkombëtar zgjedhor ekzaminon gjendjet që kanë të bëjnë me të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur, duke përfshirë, në mes tjerash, diskriminimin apo pengesat tjera që pengojnë pjesëmarrjen në proceset zgjedhore, bazuar në mendimet politike apo të tjera, gjininë, racën, ngjyrën, etnicitetin, gjuhën, religjionin, origjinën nacionale apo sociale, pronën, statusin e lindjes apo statusin tjetër p.sh. paaftësinë fizike. Raportet e misioneve ndërkombëtare të zgjedhjeve ofrojnë një pikë faktike të përbashkët të referencës për të gjithë personat e interesuar në zgjedhje, duke përfshirë edhe konkurruesit politik. Kjo veçanërisht mund të jetë e dobishme në rast të zgjedhjeve polemizuese, aty ku raportet objektive dhe të sakta mund të ndihmojnë në zbutjen e konfliktit.
6. Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve kryhet për dobi të njerëzve të atij vendi ku mbahen zgjedhjet dhe për dobi të komunitetit ndërkombëtar. Vëzhgimi ndërkombëtar është i orientuar kah procesi, e jo i lidhur me ndonjë rezultat të caktuar elektoral, dhe është i interesuar që rezultatet të raportohen në mënyrë të ndershme dhe të saktë, në një formë transparente dhe me kohë. Asnjë person nuk duhet lejuar të jetë anëtar i ndonjë misioni vëzhgues ndërkombëtar gjersa ai person të mos jetë i lirë nga ndonjë interes politik, ekonomik apo i liruar nga

konfliktet e tjera të interesit, që do të mund të kishin ndikim apo ndërhyrje në kryerjen e saktë të vëzhgimeve dhe objektivitetit dhe/apo do të mund të bienin ndesh me nxjerrjen e saktë dhe objektive të konkludimeve rreth karakterit të procesit zgjedhor. Këto kritere duhet të plotësohen në mënyrë efektive gjatë periudhave të vëzhgimit afat-gjatë, sikur se edhe gjatë periudhave të kufizuara të vëzhgimit në ditën e zgjedhjeve, ku çdo periudhë paraqet sfidë specifike për analizë të pavarur dhe objektive. Misionet ndërkombëtare të vëzhgimit zgjedhor nuk duhet të pranojnë mjete financiare apo përkrahje infrastrukturore nga qeveritë, zgjedhjet e të cilave do të vëzhgohen, pasi mund të paraqesin një konflikt të qartë interesi dhe të zvogëlojnë besueshmërinë e integritetit të raportit të misionit. Delegacionet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve do të jenë të gatshëm të tregojnë burimet e financimit të tyre në rast të ndonjë kërkesë adekuate dhe të arsyeshme.

7. Nga misionet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve pritet që të lëshojnë për publikun deklarata me kohë, të sakta dhe paanshme (duke përfshirë dhënien e kopjeve autoriteteve elektorale dhe entiteteve përkatëse nacionale), duke prezentuar raportet e tyre, konkluzionet dhe ndonjë rekomandim përkatës që do të ndihmonte përmirësimin e proceseve që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Misionet duhet të njoftojnë publikisht prezencën e tyre në një vend, duke përfshirë mandatin e misionit, përbërjen dhe kohëzgjatjen e misionit, të bëjnë raporte periodike dhe të lëshojnë deklarata preliminare pas-zgjedhore të konkluzioneve dhe një raport final pas mbylljes së procesit zgjedhor. Misionet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve gjithashtu mund të bëjnë mbledhje private me ata që janë të përfshirë në organizimin e zgjedhjeve të drejta demokratike në një vend, për të diskutuar raportet e misionit, konkludimet dhe rekomandimet. Misionet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve gjithashtu mund t'i raportojnë organizatave të tyre përkatëse ndër-qeveritare apo jo-qeveritare ndërkombëtare.
8. Organizatat që nënshkruajnë këtë Deklaratë dhe Kodin e Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve zotohen se do të kooperojnë ndërmjet vete në ushtrimin e misioneve ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve. Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve mund të kryhet, p.sh., nëpërmes: misioneve individuale të vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve; ad-hoc misioneve ndërkombëtare vëzhguese të përbashkëta; apo nëpërmes misioneve të koordinuara ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve. Në të gjitha rastet, organizatat miratuese zotohen që do të punojnë së bashku për të maksimizuar kontributin e misioneve të tyre ndërkombëtare.
9. Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve duhet të bëhet duke respektuar sovranitetin e vendit ku mbahen zgjedhjet dhe duke respektuar të drejtat e njeriut të popullit të atij vendi. Misionet e vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve duhet të respektojnë ligjet e vendit mikëpritës, sikur se edhe autoritetet nacionale, duke përfshirë trupin elektorale, dhe të veprojnë në përputhje me respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

10. Misionet e vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve duhet në mënyrë aktive të kërkojnë kooperim me autoritetet elektorale të vendit mikëpritës dhe nuk duhet të pengojnë procesin e zgjedhjeve.
11. Vendimi i ndonjë organizate për të organizuar një mision për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve apo për të hulumtuar mundësinë e organizimit të një misioni vëzhgues nuk do të thotë që kjo organizatë mendon që procesi elektorale në atë vend do të jetë domosdo kredibil. Organizata nuk duhet të dërgojë ndonjë mision për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve në ndonjë vend nën kushte që do ta bënin prezencën e atij misioni të interpretohet sikur i jipet legjitimitet një procesi të qartë jodemokratik elektorale, dhe misionet e vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve që gjenden në ndonjë rrethanë të tillë duhet të bëjnë deklarata publike për të siguruar që prezenca e tyre nuk implikon një legjitimitet të tillë.
12. Me qëllim që një mision për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve të jetë efektiv dhe kredibil në punën e tij, duhet që të plotësohen disa parakushte themelore. Prandaj, një mision për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve nuk duhet të organizohet gjersa vendi ku mbahen zgjedhjet nuk merr veprimet e mëposhtme:
 - a. Lëshon një ftesë apo në ndonjë mënyrë tjetër indikon vullnetin e tij për të pranuar misionet për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve, në pajtueshmëri me kërkesat e çdo organizate, me qëllim të lejimit të analizave të të gjitha proceseve që janë të rëndësishme në organizimin e zgjedhjeve të drejta demokratike.
 - b. Garanton qasje të papenguar të misionit për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve në të gjitha fazat e procesit elektorale dhe teknologjive elektorale, duke përfshirë teknologjitë elektronike dhe proceset e certifikimit për votuesit elektronik dhe të teknologjive tjera, pa kërkuar që misionet vëzhguese elektorale të hyjnë në çështjet konfidenciale apo marrëveshjet tjera konfidenciale lidhur me teknologjitë apo proceset e zgjedhjes, dhe që pranon që misionet e vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve mund mos t'i certifikojnë këto teknologji si të pranueshme;
 - c. Garanton qasje të papenguar të të gjithë personave që kanë të bëjnë me proceset elektorale, përfshirë:
 - i. zyrtarët elektorale të të gjitha niveleve, në rast të kërkesave të arsyeshme,
 - ii. anëtarëve të trupave legjislativ dhe të qeverisë dhe zyrtarëve të sigurisë, funksioni i të cilëve është relevant në organizimin e zgjedhjeve të drejta demokratike.
 - iii. të gjitha partive politike, organizatave dhe personave që kanë kërkuar të garojnë në zgjedhje (duke përfshirë ata që janë kualifikuar, ata që janë diskualifikuar dhe ata që janë tërhequr nga pjesëmarrja) dhe ata që kanë abstenuar nga pjesëmarrja,
 - iv. personelin e mjeteve të komunikimit të lajmeve, dhe

- v. të gjithë organizatat dhe personat që janë të interesuar në arritjen e zgjedhjeve të drejta demokratike në vend;
- d. Garanton liri të lëvizjes në vend për të gjithë anëtarët e misionit për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve;
- e. Garanton që misionet e vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve janë të lirë që pa ndërhyrje të lëshojnë deklarata publike dhe raporte lidhur me konkluzionet dhe rekomandimet e tyre lidhur me proceset dhe zhvillimet elektorale;
- f. Garanton që asnjë autoritet qeveritar, i sigurisë apo elektorale nuk do të ndërhyjë në zgjedhjen individuale të vëzhguese apo anëtarëve tjerë të misionit për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve apo të bëjë përpjekje për të kufizuar numrin e tyre;
- g. Garanton akreditim të plotë, në tërë vendin (nënkupton lëshimin e ndonjë identifikimi apo dokumenti që kërkohet për të kryer vëzhgimin e zgjedhjeve) për të gjithë personat e zgjedhur si vëzhgues apo pjesëmarrësit tjerë të misionit për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve gjersa misioni pajtohet me kërkesat qartë të definuara, të arsyeshme dhe jo-diskriminuese për akreditim;
- h. Garanton që asnjë autoritet qeveritar, i sigurisë apo elektorale nuk do të ndërhyjë në aktivitetet e misionit për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve; dhe
- i. Garanton që asnjë autoritet qeveritar nuk do të bëjë presion, nuk do të kërcënojë veprime kundër apo të merr masa ndëshkimore kundër ndonjë qytetari vendor apo të huaj i cili punon, asiston apo ofron informacione për misionin i cili kryen vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve në pajtim me parimet ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve.

Si kusht paraprak të organizimit të një misioni ndërkombëtar për vëzhgim të zgjedhjeve, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare mund të kërkojnë që këto garancione të përmbledhen në formë të një memorandumi mirëkuptimi apo ndonjë dokumenti të ngjashëm, në marrëveshje me autoritetet qeveritare dhe/apo elektorale. Vëzhgimi i zgjedhjeve është një aktivitet civil, dhe dobia nga ky vëzhgim mund të vëhet në pikëpyetje në rrethana që paraqesin rrezik për sigurinë, apo që kufizojnë shpërndarjen e sigurtë të vëzhguesve apo që në ndonjë mënyrë tjetër do të mund të ndikojnë në mënyrë negative në përdorimin e metodologjive kredibile të vëzhgimit të zgjedhjeve.

13. Misionet ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve duhet të përpiqen dhe të kërkojnë praninë të prezencës së tyre nga të gjithë konkurruesit kryesor politik.

14. Pjesëmarrësit politik (partitë, kandidatët dhe përkrahësit e pozicioneve në referendum) kanë interesat personale në procesin elektoral nëpërmes të drejtës së tyre për t'u zgjedhur dhe për të marrë pjesë drejtpërdrejtë në qeveri. Prandaj, ata duhet lejuar për të monitoruar të gjitha proceset që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe të vëzhgojnë procedurat, përfshirë në mes tjerash edhe funksionimin e teknologjive elektronike dhe tjera elektorale brenda qendrave votuese, qendrave të numërimit dhe qendrave ndihmëse elektorale, sikur se edhe transportimin e fletëvotimeve dhe materialeve tjera senzitive.
15. Misionet për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve duhet të:
- a. Vendosin komunikime me të gjithë konkurruesit politik të procesit zgjedhor, duke përfshirë përfaqësuesit e partive politike dhe kandidatët që mund të kenë informacione lidhur me integritetin e procesit zgjedhor;
 - b. mirëpresin informacionet e ofruara nga ata lidhur me natyrën e procesit;
 - c. vlerësojnë, si një aspekt të rëndësishëm të vëzhgimit ndërkombëtar zgjedhor, nëse pjesëmarrasve politik iu është lejuar qasje, në baza jodiskriminuese, në verifikimin e integritetit të të gjitha elementeve dhe fazave të procesit zgjedhor. Misionet ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve duhet që, në rekomandimet e tyre të cilat mund të lëshohen në formë të shkruar apo të prezentohen në forma tjera në faza të ndryshme të procesit zgjedhor; të avokojnë për heqjen e çdo kufizimi të papërshtatshëm, apo të ndërhyjnë kundër aktiviteteve të konkurruesve politik me qëllim të sigurimit të integritetit të procesit elektoral.
16. Qytetarët kanë të drejtën e njohur ndërkombëtarisht për t'u asociuar dhe të drejtë për të marrë pjesë në punët qeveritare dhe publike në vendet e tyre. Këto të drejta mund të ushtrohen nëpërmes organizatave joqeveritare që monitorojnë të gjitha proceset që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe procedurat vëzhguese, duke përfshirë në mes tjerash edhe funksionimin e teknologjive elektronike dhe tjera elektorale brenda qendrave votuese, qendrave të numërimit dhe qendrave tjera ndihmëse elektorale, sikur se edhe transportin e fletëvotimeve dhe materialeve tjera të ndieshme. Misionet ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve duhet të vlerësojnë dhe të raportojnë nëse organizatat jopartiake vendore për monitorim të zgjedhjeve dhe vëzhgim, janë në gjendje që në baza jodiskriminuese, të kryejnë aktivitetet e tyre pa kufizime apo ndërhyrje të paligjshme. Misionet ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve duhet të avokojnë për të drejtat e qytetarëve për vëzhgim vendor të pavarur të zgjedhjeve pa ndonjë kufizim apo ndërhyrje të paligjshme dhe duhet që në rekomandimet e tyre të adresojnë largimin e ndonjë kufizimi apo ndërhyrje të tillë.
17. Misionet për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve duhet të identifikojnë, vendosin komunikime të rregullta dhe të koepërojnë në mënyrë përkatëse me organizatat jopartiake vendore për monitorim të zgjedhjeve. Misionet për

vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve duhet të mirëpresin informacionet e ofruara nga këto organizatat lidhur me natyrën e procesit zgjedhor. Pas vlerësimit të pavarur të informacioneve të ofruara nga këto organizatat, konkluzionet e tyre mund të ofrojnë një plotësim të rëndësishëm për konkluzionet e misioneve ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve, megjithëse misionet ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve duhet të mbesin të pavarura. Prandaj, misionet për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve duhet të bëjnë çdo përpjekje të arsyeshme për t'u konsultuar me organizatat e tilla para se të lëshojnë ndonjë deklaratë.

18. Organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare nënshkruese të kësaj Deklarate njohin progresin substancial që është bërë në vendosjen e standardeve, parimeve dhe zotimeve lidhur me zgjedhjet e drejta demokratike dhe zotohen në përdorimin e një deklaratë të parimeve të tilla në bërjen e vëzhgimeve, gjykimeve dhe konkluzioneve rreth karakterit të proceseve zgjedhore dhe premtojnë që të jenë transparente rreth parimeve dhe metodologjive vëzhguese që i përdorin.
19. Organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare nënshkruese të kësaj Deklarate njohin ekzistimin e një varieteti të metodologjive kredibile për vëzhgimin e proceseve zgjedhore dhe zotohen në harmonizimin e metodologjive të duhura. Ato gjithashtu pranojnë që misionet për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve duhet të jenë me numër të mjaftueshëm për të përcaktuar në mënyrë të pavarur dhe paanësisht karakterin e proceseve zgjedhore në një vend dhe duhet të kenë kohëzgjatje të mjaftueshme për të përcaktuar karakterin e të gjitha elementeve kritike të procesit zgjedhor në periudhën para-zgjedhore, në ditën e zgjedhjes dhe periudhën pas-zgjedhore – përveç nëse një aktivitet vëzhgues nuk është i fokusuar dhe nuk komenton vetëm një apo një numër të kufizuar të elementeve të procesit zgjedhor. Ato më tutje pranojnë që është e domosdoshme mos të izolojnë apo mos të tej-theksojnë vëzhgimet në ditën e zgjedhjeve, dhe që vëzhgimet e tilla duhet të vendosen në kontekst të të gjithë procesit elektoral.
20. Organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare nënshkruese të kësaj Deklarate pranojnë që misionet ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve duhet të përfshijnë personat me shkathtësi të mjaftueshme të shumëllojshme politike dhe profesionale, integritet të vërtetuar për të vëzhguar dhe gjykuar proceset në aspekt të: njohurive në proceset elektorale dhe parimet elektorale; të drejtat ndërkombëtare të njeriut; ligjet zgjedhore komparative dhe praktikatat administrative (përfshirë përdorimin e kompjuterit dhe teknologjive tjera zgjedhore); proceset komparative politike dhe faktorët specifik vendor. Organizatat nënshkruese gjithashtu pranojnë rëndësinë e balancit gjinor në përbërjen e pjesëmarrësve dhe lidërshiptit të misioneve ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve, sikur se edhe shumëllojshmërinë qytetare në misione të tilla.
21. Organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare qeveritare nënshkruese të kësaj Deklarate zotohen që:

- a. të njoftojnë të gjithë pjesëmarrësit rreth misioneve të tyre ndërkombëtare për vëzhgim të zgjedhjeve lidhur me principet e saktësisë së informacioneve dhe paanshmërisë politike në marrjen e gjykimeve dhe konkluzioneve;
 - b. të ofrojnë referenca apo dokumente të ngjashme, që shpjegojnë qëllimet e misionit;
 - c. ofrojnë informacione lidhur me ligjet dhe rregullat relevante nacionale, ambientin e përgjithshëm politik dhe çështjet tjera, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mirëqenien e vëzhguesve;
 - d. të japin instruksione të gjithë pjesëmarrësve në misionit për vëzhgim të zgjedhjeve lidhur me metodologjitë që do të përdoren; dhe
 - e. të kërkojnë nga të gjithë pjesëmarrësit në misionin për vëzhgim të zgjedhjeve që të lexojnë dhe të zotohen që të veprojnë në përputhje me Kodin e Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve, që e shoqëron këtë Deklaratë dhe i cili mund të modifikohet pa ndryshuar përmbajtjen e saj, me qëllim të përshtatjes me kërkesat e organizatës, apo të zotohen që të veprojnë në përputhje me kodin pre-ekzistues të sjelljes të organizatës që është substancialisht e njëjtë sikur Kodi i Sjelljes.
22. Organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare nënshkruese të kësaj Deklarate zotohen që do të bëjnë çdo përpjekje për t'iu bindur kushteve të Deklaratës dhe Kodit të Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve. Në çdo kohë që organizata nënshkruese mendon që është e nevojshme për t'u shmangur nga ndonjë kusht i Deklaratës apo Kodit të Sjelljes, me qëllim të kryerjes së vëzhgimit të zgjedhjeve në frymën e Deklaratës, organizata do të shpjegojë me deklaratë publike dhe do të jetë e përgaditur për t'iu përgjigjur pyetjeve përkatëse nga organizatat tjera nënshkruese se pse ishte e nevojshme për të bërë një veprim të tillë.
23. Organizatat nënshkruese pranojnë që qeveritë të dërgojnë delegacione vëzhgimi në zgjedhjet në vendet tjera dhe që të tjerët gjithashtu t'i vëzhgojnë zgjedhjet. Organizatat nënshkruese mirëpresin vëzhguesit e tillë që pajtohen *ad hoc* me këtë deklaratë dhe veprojnë në përputhje me Kodin e Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve.
24. Kjo Deklaratë dhe Kodi i bashkangjitur i Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve kanë synim të jenë dokumente teknike që nuk kërkojnë ndonjë veprim nga trupat politik të organizatave nënshkruese (siq janë p.sh. asamblatë, këshillat apo bordet e drejtorave), megjithëse veprimet e tilla janë të mirëseardhura. Kjo Deklaratë dhe Kodi i bashkangjitur i Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve mbetet i hapur për miratim nga organizatat tjera ndërqeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare. Miratimet duhet të regjistrohen në Divizionin për Asistencë Elektorale në Kombet e Bashkuara.

KODI I SJELLJES PËR VËZHguesIT NDËRKOMBËTAR TË ZGJEDHJEVE

Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve është një gjë e pranuar në botë. Ai bëhet nga organizatat dhe asociacionet ndërqeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare me qëllim të ofrimit të një vlerësimi të paanshëm dhe të saktë rreth natyrës së proceseve zgjedhore, në dobi të popullatës së vendit ku mbahen zgjedhjet dhe në dobi të komunitetit ndërkombëtar. Prandaj, shumë varet nga sigurimi i një integriteti të vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve, dhe të gjithë ata që janë pjesë e misionit ndërkombëtar të vëzhgimit të zgjedhjeve, përfshirë vëzhguesit afat-gjatë dhe afat-shkurtër, anëtarët e delegacioneve vlerësuese, ekipet e specializuara të vëzhgimit dhe liderët e misioneve, duhet të pajtohen dhe t'i përmbahen këtij Kodi të Sjelljes.

Respekto Sovranitetin dhe të Drejtat Njerëzore Ndërkombëtare

Zgjedhjet janë shprehje e sovranitetit, i cili i takon njerëzve të një vendi, vullneti i lirë i të cilëve ofron bazë për autoritet dhe legjitimitet të qeverisë. Të drejtat e qytetarëve për të votuar dhe për t'u zgjedhur në zgjedhje periodike, të drejta, janë të drejta të njeriut të njohura ndërkombëtarisht, dhe kërkojnë ushtrimin e një numri të të drejtave dhe lirive themelore. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të respektojnë sovranitetin e vendit mikëpritës, sikur se edhe të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve të atij vendi.

Respekto Ligjet e Vendit dhe Autoritetin e Trupit Elektorale

Vëzhguesit duhet të respektojnë ligjet e vendit mikëpritës dhe autoritetin e trupit i cili është i ngarkuar me administrimin e procesit elektorale. Vëzhguesit duhet të ndjekin çdo instruksion ligjor të dhënë nga qeveria e vendit, autoritetet e sigurisë dhe autoritetet elektorale. Vëzhguesit gjithashtu duhet të mbajnë një qëndrim respektues ndaj zyrtarëve elektorale dhe autoriteteve tjera nacionale. Vëzhguesit gjithashtu duhet të kushtojnë vëmendje nëse ligjet, rregullativat apo veprimet e shtetit dhe/apo zyrtarëve elektorale në mënyrë të padrejtë e ngarkojnë apo e pengojnë ushtrimin e të drejtave që kanë të bëjnë me zgjedhjet, të drejta të garantuara me ligj, kushtetutë apo instrumente të aplikueshme ndërkombëtare.

Respekto Integritetin e Misionit Ndërkombëtar për Vëzhgim të Zgjedhjeve

Vëzhguesit duhet të respektojnë dhe të mbrojnë integritetin e misionit ndërkombëtar për vëzhgim të zgjedhjeve. Kjo përfshin Kodin e Sjelljes, çdo instruksion të shkruar (si p.sh. kushtet e referimit, direktivat dhe udhëzimet) dhe çdo instruksion verbal të dhënë nga lidhshipi i misionit vëzhgues. Vëzhguesit duhet të marrin pjesë në të gjitha konsultimet (para fillimit të një pune dhe pas kryerjes - "briefingjet dhe debriefingjet") e kërkuara nga misioni vëzhgues dhe trajnimet dhe të njihet me ligjet zgjedhore, rregullativat dhe ligjet tjera relevante të udhëzuara nga misioni vëzhgues; dhe në mënyrë të kujdesshme të mbështetet në metodologjitë e përdorura nga misioni vëzhgues. Vëzhguesit gjithashtu duhet t'i raportojnë lidhshipit të misionit vëzhgues për çdo konflikt interesi që mund të kenë dhe ndonjë sjellje të papërshtatshme që shohin të kenë bërë ndonjë vëzhgues tjetër që është pjesë e misionit.

Mbaj në Mënyrë Rigoroze Paanshmërinë Politike Gjatë Tërë Kohës

Vëzhguesit duhet të mbajnë në mënyrë rigoroze paanshmërinë politike gjatë tërë kohës, duke përfshirë edhe kohën e lirë në vendin mikëpritës. Ata nuk duhet të shprehin apo shfaqin ndonjë paragjykim apo preferencë në lidhje me autoritetet nacionale, partitë politike, kandidatët, çështjet e referendumit apo në lidhje me ndonjë çështje të diskutueshme të procesit zgjedhor. Vëzhguesit gjithashtu nuk duhet të kryejnë ndonjë aktivitet që do të shihej si favorizim apo përfitim partiak për ndonjë konkurrent politik në vendin mikëpritës, si p.sh. mbajtja apo ekspozimi i ndonjë simboli partiak, ngjyre, flamuri apo të pranoj ndonjë gjë të çmueshme nga konkurrentët politik.

Mos Pengo Proceset Zgjedhore

Vëzhguesit nuk duhet të pengojnë asnjë element të procesit zgjedhor, përfshirë proceset para-zgjedhore, votimin, numërimin dhe tabelimin e rezultateve dhe proceseve që ngjajnë pas ditës së zgjedhjeve. Vëzhguesit mund t'i parashtrojnë menjëherë zyrtarëve të zgjedhjes vërejtjet rreth parregullsive, mashtrimeve apo problemeve signifikante, përveç nëse kjo nuk është e ndaluar me ligj, dhe duhet ta bëjnë këtë në një mënyrë jo-obstruktive. Vëzhguesit mund t'iu bëjnë pyetje zyrtarëve të zgjedhjes, prezentuesve të partive politike dhe vëzhguesve tjerë brenda qendrave votuese dhe mund të japin përgjigje rreth aktiviteteve të tyre, nëse me këtë nuk e pengojnë procesin zgjedhor. Gjatë dhënies së përgjigjeve vëzhguesit nuk duhet të japin përshtypje të drejtimit të procesit zgjedhor. Vëzhguesit mund të bëjnë pyetje dhe t'iu përgjigjen pyetjeve të votuesve por nuk duhet t'i pyesin ata për cilën parti apo cilin pozicion të referendumit kanë votuar.

Ofro Identifikim Adekuat

Vëzhguesit duhet të ekspozojnë idenfikimin e dhënë nga misioni i vëzhgimit të zgjedhjes, sikur se edhe identifikimin e kërkuar nga autoritetet nacionale, dhe duhet t'i paraqesin ato zyrtarëve zgjedhor dhe autoriteteve tjera të interesuar nacionale në rast se kjo kërkohet nga ata.

Mbaj Saktësinë e Vëzhgimit dhe Profesionalizmin gjatë Nxjerrjes së Konkluzioneve

Vëzhguesit duhet të sigurojnë që të gjitha vëzhgimet e tyre janë të sakta. Vëzhgimet duhet të jenë gjithëpërfshirëse, duke përmendur faktorët pozitiv si dhe ata negativ, të bëjë dallim në mes të faktorëve signifikant dhe jo-signifikant dhe të identifikojë strukturat që kanë mundur të kenë ndikim të rëndësishëm në integritetin e procesit zgjedhor. Gjykimet e vëzhguesve duhet të bazohen në standardet më të larta për saktësi të informacioneve dhe paanshmëri të analizave, duke bërë dallim të faktorëve subjektiv nga faktet objektive. Vëzhguesit duhet t'iu bazojnë të gjitha konkluzionet në dëshmitë faktike dhe të verifikueshme dhe mos të nxjerrin konkluzione para kohe. Vëzhguesit gjithashtu duhet të mbajnë mirë të dokumentuar vendet ku kanë vëzhguar, vëzhgimet e bëra dhe informacionet tjera relevante që kërkohen nga misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve, dhe këto dokumentacione duhet t'iu japin misionit.

Përmbahu nga Dhënia e Komenteve Publikut apo Mediave para se Misioni të jep Deklaratë

Vëzhguesit duhet të përmbahen nga dhënia e komenteve personale rreth vëzhgimit apo konkluzioneve të tyre mjeteve të komunikimit apo anëtarëve në publik para se misioni për vëzhgimin e zgjedhjes nuk jep një deklaratë, përveq në rast të instruksioneve specifike dhënë nga lidershipi i misionit vëzhgues. Vëzhguesit mund të shpjegojnë natyrën e misionit vëzhgues, aktivitetet e tij dhe çështjet tjera që janë përkatëse për misionin vëzhgues dhe duhet t'i drejtojnë mediat apo personat e interesuar drejt atyre individëve që janë emërtuar nga misioni vëzhgues.

Bashkëpunohet me Vëzhguesit Tjerë Zgjedhor

Vëzhguesit duhet të jenë të njoftuar me misionet tjera të vëzhgimit të zgjedhjeve, ato ndërkombëtare dhe vendore, dhe të koeporojë me to sipas instruksioneve të dhëna nga lidershipi i misionit vëzhgues.

Tregohet Sjellje të Duhura Personale

Vëzhguesit duhet të tregojnë sjellje të duhura personale dhe të respektojnë të tjerët, përfshirë shfaqjen e ndieshmërisë për kulturat dhe zakonet e vendit mikëpritës, të shfaqin gjykime të shëndosha gjatë interaksioneve personale dhe nivel më të lartë të sjelljes profesionale gjatë tërë kohës, duke përfshirë kohën e lirë.

Shkelja e këtij Kodi të Sjelljes

Në rast të ndonjë brengje për shkelje të këtij Kodi të Sjelljes, misioni për vëzhgim të zgjedhjeve duhet të kryejë hetim të çështjes. Nëse zbulohet që është bërë ndonjë shkelje serioze, vëzhguesit në fjalë mund t'i tërhiqet akreditimi apo të shkarkohet nga misioni për vëzhgim të zgjedhjes. Autoritet për vendime të tilla është lidershipi i misionit për vëzhgim të zgjedhjes.

Zotimi për zbatimin e Kodit të Sjelljes

Çdo person i cili merr pjesë në këtë mision të vëzhgimit të zgjedhjes duhet të lexojë dhe të kuptojë këtë Kod të Sjelljes dhe duhet të nënshkruajë premtimin (zotimin) për zbatim të tij.

ZOTIMI PËR KODIN E SJELLJES PËR VËZHguesIT NDËRKOMBËTAR TË ZGJEDHJEVE

Unë kam lexuar dhe kuptuar Kodin e Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve dhënë nga misioni ndërkombëtar për vëzhgim të zgjedhjeve. Nëpërmes kësaj Unë zotohem që do të zbatoj Kodin e Sjelljes dhe që të gjitha aktivitetet e mia si vëzhgues i zgjedhjes do të kryhen plotësisht në përputhje me të. Unë nuk kam asnjë konflikt interesi, politik, ekonomik apo tjetër, që do të interferonte me aftësinë time për të qenë vëzhgues i paanshëm i zgjedhjes dhe për të zbatuar Kodin e Sjelljes.

Unë do të mbaj në mënyrë rigorozë paanshmërinë politike gjatë gjithë kohës. Unë do të bëjë gjykimet e mia bazuar në standardet më të larta për saktësi të informacioneve dhe paanshmëri të analizave, duke i ndarë faktorët subjektive nga dëshmitë objektive, dhe konkluzionet e mia do t'i bazoj në dëshmitë faktike dhe të verifikueshme.

Unë nuk do të pengoj procesin zgjedhor. Unë do të respektoj ligjet nacionale dhe autoritetin e zyrtarëve zgjedhor dhe do të mbaj qëndrim respektues ndaj autoriteteve elektorale dhe autoriteteve tjera nacionale. Unë do të respektoj dhe avancojë të drejtat humane dhe liritë themelore të njerëzve të vendit. Unë do të mbaj sjellje të duhura personale dhe do të respektoj të tjerët, duke përfshirë shfaqjen e ndieshmërisë për kulturat dhe zakonet e vendit mikëpritës, do të shfaq gjykime të shëndosha gjatë interaksioneve personale dhe nivel më të lartë të sjelljes profesionale gjatë tërë kohës, duke përfshirë kohën e lirë.

Unë do të mbroj integritetin e misionit ndërkombëtar për vëzhgim të zgjedhjes dhe do të zbatoj instrukcionet e misionit vëzhgues. Unë do të marr pjesë në konsultimet dhe trajtimet e kërkuara nga misioni për vëzhgim të zgjedhjes dhe do të bashkëpunoj në paraqitjen e deklaratave dhe raporteve të tij, sipas kërkesave. Unë do të përmbahem nga komentet personale, vëzhgimet apo konkluzionet nëpër mjete të komunikimit apo publik, para se misioni për vëzhgim të zgjedhjeve të mos bëjë një deklaratë, përveq në rast të instrukcioneve specifike tjera të dhëna nga lidershpi i misionit vëzhgues.

Nënshkruar _____
Emri në shkronja shtypi _____
Data _____

MIRËNJOHJE

Deklarata e Principeve për Vëzhguesit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve dhe Kodi i Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve u zhvilluar gjatë një procesi shumëvjeçar, duke përfshirë më tepër se 20 organizata ndërqeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare që mirren me vëzhgim të zgjedhjeve në botë.

Procesi filloi në mënyrë joformale në vitin 2001, me iniciativën e Institutit Nacional Demokratik për Çështje Ndërkombëtare (NDI) dhe Divizionit për Asistencë Elektorale të Kombeve të Bashkuara (UNEAD) dhe në fillim përfshiu një mbledhje në KB në Neë York dhe një mbledhje në Ëashington, organizuar nga OAS dhe NDI.

Duke ndërtuar një bazë të tillë, UNEAD, Qendra Karter dhe NDI formuan një sekretariat të përbashkët dhe lancuan fazën formale të procesit në Tetor 2003, në mbledhjen e mbajtur në Qendrën Karter në Atlanta. Pastaj, vazhoi me mbledhjen e Shtatorit 2004 në Bruksel, organizuar nga Komisioni Evropian. Ndërmjet organizatave pjesëmarrëse u përhap një proces konsultativ, i cili rezultoi me një dokument i cili u ofrua për miratim në fillim të Korrikut 2005.

Sekretariati ishte i përbërë nga Carina Perelli dhe Sean Dunne nga UNEAD, David Carroll, David Pottie dhe Avery Davis-Robers nga Qendra Karter dhe Patrick Merloe dhe Linda Patterson nga NDI. Anëtarët e sekretariatit i përgaditën dokumentet, me Mr. Merloe si draft propozues kryesor, duke ndërtuar një trup substancial të dokumenteve ekzistuese nga organizatat e përfshira në vëzhgim të zgjedhjeve. Gjatë procesit, sekretariati pranoi kontribute kritike dhe komente nga shumë organizata pjesëmarrëse.

Procesi u përkrah me asistencë financiare nga Kombet e Bashkuara, Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Komisioni Evropian, Republika e Gjermanisë dhe Fondacioni Starr, sikur se edhe nga një numër i kontribuesve individual.